



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS
INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

Ngarkesa: 4 kredite : 40 orë; 40 seminare: 40 orë gjithsej
Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti i III, semestri: II
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe
Kodi i etikës: Kodi i etikës UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo lëndë synon të njohë studentët me institucionet ndërkombëtare në aksin sinkronik. Studentët pajisen me njohuri bazë të funksionit, rolit dhe veprimtarisë së institucioneve ndërkombëtare në planin ndërkombëtar, shtetëror si edhe atë individual. Lënda synon gjithashtu ndërthurjen e njohurive gjuhësore në gjuhën frënge me ato tematike dhe jashtëgjuhësore të fushës së institucioneve ndërkombëtare.

Objektivat specifike lëndore: Përpos ofrimit të njohurive gjuhësore dhe specifike të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare duke sjellë një panoramë të sjelljes së aktorëve publikë dhe privatë, objektivi tjetër specifik lidhet me zhvillimin e aftësisë për të zhvilluar kompetencën e të reflektuarit në mënyrë kritike në kontekstin e zhvillimit të shoqërisë ndërkombëtare nëpërmjet institucionit. Studenti do të njohë se si të përdorë informacionin e njohurive jashtëgjuhësore në funksion të profesionit të tij të ardhshëm që ka gjuhët e huaja në qendër të tij si edhe të përpunojë një material-tekst, në një terminologji teknike.

Rezultate të pritshme :

Zhvillim i aftësisë për të përpunuar materiale që lidhen me aspektet gjuhësore të terminologjisë së fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare.

Zhvillim i aftësisë për të ushtruar mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ duke prodhuar një argumentim të arsyetuar në lidhje me problematikat e shoqërisë ndërkombëtare por edhe lokale.

Zhvillim i aftësisë për të përzgjedhur dhe referuar bibliografi shkencore të mirëfilltë.

Zhvillim i aftësisë për të ndërmarrë studime të mëtijshme për ndërmarrje autonome në punën shkencore